



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, në datën 6 prill 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e raportit të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, për periudhën 26 mars 2021 - 03 prill 2021. (**Vendimi nr. 51, datë 06.04.2021**)
2. Përcaktimin e listës së subjekteve OSHMA që do të monitorohen për mbulimin e fushatës zgjedhore, në datat 04 prill 2021 - 10 prill 2021. (**Vendimi nr. 52, datë 06.04.2021**)
3. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “ERI A&A” sh.p.k., për kalimin e të drejtave të autorizimit, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Eri A&A”, te shoqëria “Tele.co.Albania” sh.p.k. (**Vendimi nr. 53, datë 06.04.2021**)
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Mariuxho” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Bulqiza” dhe zgjedhjen e zonës së ofrimit të shërbimit duke hequr dorë nga zona “*Njësia administrative Maqellarë*”. (**Vendimi nr. 54, datë 06.04.2021**)
5. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Taulant Hajdini për kalimin e të drejtave që burojnë nga autorizimi i për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Network Albania” tek shoqëria “NETWORK ALBANIA” sh.p.k. (**Vendimi nr. 55, datë 06.04.2021**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 06.04.2021